VENDIM
Nr. 434, datë 26.6.2019

PËR FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË SË MUZEUT KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 208, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së organizimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe".

2. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" është person juridik, publik, buxhetor, i cili ushtron veprimtarinë e tij si një institucion i specializuar në fushën muzeore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.

3. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" është muze qendror, i specializuar, publik, që gëzon statusin "Muze kombëtar".

4. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" ka për mision përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit.

5. Burimet e financimit të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" janë, si më poshtë vijon:

a) Buxheti i shtetit;

b) Burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË MUZEUT KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"

1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Të organizojë punën për ekspozimin, pasurimin, propagandimin, studimin e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe të kujtesës kolektive të lidhura me dhunën psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit;

b) Të organizojë punën për të siguruar dokumentimin e fakteve historike dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të lidhur me përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist dhe kontrollin e qytetarëve nëpërmjet përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit;

c) Të ofrojë shërbime për publikun në funksion të përmbushjes së përgjegjësive funksionale të tij.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MUZEUT KOMBËTAR TË PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"

1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" organizohet në nivel qendror.

2. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi, të statutit dhe të rregullores së tij.

3. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" e realizon veprimtarinë e tij në bashkëpunim me:

a) organet e administratës shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

b) rrjetin muzeor shqiptar;

c) muzetë kombëtarë, muzetë tipologjikë, muzetë vendorë, muzetë privatë, për të tërhequr në fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si dhe për ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta;

ç) institucionet shkencore, kulturore, artistike e fetare, individët, personat fizikë e juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin dhe restaurimin e objekteve, pjesë e fondit të tij, që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore;

d) institucionet e huaja simotra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë në çdo rast miratimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërorë.

5. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

6. Marrëdhëniet juridike të punës së drejtorit, nëpunësve dhe të punonjësve të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Zbaton politikën e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, në fushën e ekspozimit, të pasurimit, propagandimit, studimit, mbrojtjes, konservimit dhe të restaurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore e të kujtesës kolektive;

b) Ruan e studion provat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike e kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin e argëtimin;

c) Siguron disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut për vizitorët dhe studiuesit;

ç) Bashkëpunon me subjektet arsimore, duke u ofruar personave të të gjitha moshave mundësi për të mësuar nëpërmjet kontaktit me materiale origjinale;

d) Organizon aktivitete, të cilat përmbushin vizionin dhe misionin e tij në përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist e të kontrollit të qytetarëve përmes ish-Sigurimit të Shtetit;

dh) Organizon, brenda dhe jashtë vendit, çeljen e ekspozitave, me objektet që disponon, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Përgatit pasaportën shkencore të çdo objekti ekzistues apo të ri, që bëhet pjesë e fondit të tij dhe ia përcjell për regjistrim Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

ë) Kryen hulumtime profesionale e shkencore për mbledhjen, vlerësimin, dhe ekspozimin e objekteve që disponon;

f) Nxit e inkurajon, nëpërmjet projekteve, veprimtarinë kërkimore-shkencore lidhur me fondet që administron për studiuesit në fushën e historisë dhe punonjësve në fushën e muzeologjisë;

g) Inkurajon dialogun me dhe ndërmjet qytetarëve për të kaluarën, të tashmen e të ardhmen shqiptare.

8. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" drejtohet nga drejtori i muzeut, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

9. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" emërohet ose lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas kritereve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Drejtori emërohet për një mandat tre-vjeçar. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet nga ministri në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

10. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:

a) Të ketë përvojë profesionale dhe të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;

b) nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

11. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" ka kompetencat, si më poshtë vijon:

a) Drejton veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe", në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;

b) Përfaqëson Muzeun Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" në marrëdhënie me të tretët;

c) Ka të drejtë të lidhë marrëveshje për shkëmbimin e fondeve muzeore, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Procedura e ndjekur në këtë rast bëhet sipas nenit 225, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

ç) Merr masa mbrojtëse dhe ruajtjeje lidhur me fondin kombëtar të muzeut;

d) Emëron dhe liron nga detyra, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, të gjithë punonjësit e muzeut;

dh) Nxjerr urdhra e udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe";

e) Çdo kompetencë tjetër, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" ka logon dhe vulën e tij zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe"", sipas legjislacionit në fuqi.

13. Vula e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" miratohet me urdhër të Kryeministrit brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Statuti i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" miratohet nga ministri i Kulturës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe", sipas këtij vendimi, muzeu kombëtar "Gjethi" vazhdon të kryejë funksionet e tij dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës në fuqi.

4. Punonjësit aktualë të Muzeut Kombëtar "Gjethi" riorganizohen sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces udhëhiqet nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e ministrit të Kulturës.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga muzeu kombëtar "Gjethi" te Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe".

6. Vendimi nr. 208, datë 15.3.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e muzeut kombëtar "Gjethi"", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe